



Rrjeti i Grave të Kosovës

Mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë

Zbatimi i Strategjisë 2015-2018 të RrGK-së Raporti gjashtëmujor për anëtarët e RrGK-së

Shtator 2017

Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK), së bashku me organizatat anëtare të tij, ka arritur progres të dukshëm në zbatimin e Strategjisë për vitet 2015 - 2018, gjatë periudhës 6 mujore prej 1 janarit 2017 deri më 30 qershor 2017, duke arritur të zbatohet rreth 76% të Strategjisë. Rrjedhimisht, RrGK është në rrugë të mbarë për zbatimin e strategjisë së vet deri në vitin 2018 pas punës së vazhdueshme, si dhe në pritje të financimit për disa fusha, siç theksohet më poshtë. Ky dokument përmbledhë fushat kyçe të progresit të arritur në secilin objektiv të përgjithshëm (me shkronja të theksuara), objektiv specifik (me shkronja të theksuara dhe me numra, të tillë si I.I), si dhe rezultatet e pritura (me shkronja të theksuara dhe me numra, të tillë si I.I.I) nga Strategjia e RrGK-së, gjatë kësaj periudhe, siç tregohet nga progresi në treguesit e Strategjisë.

Në Kosovë ekziston lëvizje e qëndrueshme e grave

Drejt këtij objektiv të përgjithshëm është arritur progres, siç tregohet nga fakti se:

- Më shumë gra dhe burra janë regjistruar si përkrahës individual të RrGK-së, duke arritur në gjithsej 75.
- Më shumë të reja dhe të rinj kanë ndërmarrë nisma, duke demonstruar kështu aftësitë e gjeneratave të reja që të vazhdojnë lëvizjen, përfshirë edhe angazhimin e tyre aktiv në organizimin e marshit në "Ditën Ndërkombëtare të Gruas", "Një miliard në këmbë", "Mos Festo (8 marsin)", si dhe përpjekjet për të kërkuar drejtësi për Zejnepen.
- Anëtarët e RrGK dhe Lobit për Barazi Gjimore në Kosovë (LBGJK) kanë mbetur aktive.

I.I Është rritur solidariteti mes organizatave të grave në Kosovë

- Me mbështetjen e RrGK-së, organizatat e grave kanë ndërmarrë 20 partneritete, koalicione dhe nisma të përbashkëta të reja, duke arritur në gjithsej 39 sosh nga vitit 2016.

I.I.I Anëtarët e RrGK-së janë informuar për nismat e anëtareve tjera, aktivitetet e RrGK-së, mundësitë e financimit dhe informacione të tjera

- Në takimet dymujore dhe vjetore të RrGK-së kanë marrë pjesë 48 palë të reja të interesuara, duke e çuar numrin në 908, përfshirë 10.5% nga grupet etnike të pakicave dhe 2.7% nga personat me aftësi të kufizuara.

I.I.I.2 Më shumë vajza aktiviste të përfshira në RrGK

- Gjatë kësaj periudhe, në lëvizjen e grave janë përfshirë 625 të reja dhe të rinj (<30).

I.I.I.3 Forcimi i mirëkuptimit ndëretnik dhe bashkëpunimi ndërmjet individëve dhe grupeve të shoqërisë civile në Kosovë dhe Serbi

- Në vitin 2017 janë ndërmarrë 7 nisma të reja ndëretnike (duke përfshirë edhe ato midis anëtareve), duke arritur në gjithsej 41.

1.2 Është përmirësuar kapaciteti institucional i RrGGK dhe anëtareve të saj drejt avokimit dhe qëndrueshmërisë afatgjate të rrjetit

- Nga anëtarët e RrGK-së janë realizuar të paktën katër nisma të reja avokuese, të mbështetura nga Fondi i Grave të Kosovës (FGK), të cilat me sukses kanë përmbushur qëllimet e tyre, duke arritur në gjithsej 79.

1.2.1 Puna e RrGGK dhe e anëtareve të tij më e promovuar tek partnerët potencial, tek aktivistet gra në mbarë botën dhe tek përkrahësit potencial

- Mediat kanë mbuluar çështjet e rëndësishme për gra dhe vajza 51 herë (ku ishte e përfshirë RrGK-ja), duke arritur në gjithsej 393.
- Numri i ndjekësve në faqen e RrGK-së në Facebook është rritur për 6,452, duke arritur në gjithsej 14,918.
- Numri i ndjekësve të LBGJK-së në Facebook është rritur për 1,693.
- Shikimi i faqes së internetit të RrGK-së www.womensnetwork.org ka arritur në 90,430.
- Numri i sesioneve në faqen e internetit të RrGK-së ka arritur në 29,000.
- Numri i përdoruesve të faqes së internetit ka arritur në 19,000
- Numri i ndjekësve në Instagram ka arritur në 680.
- Numri i ndjekësve në Twitter ka arritur në 595.
- Numri i lexuesve të buletinit “Zëri i Grave Kosovare” është rritur në 295.
- Lidhur me faqen e internetit, mediet sociale dhe buletin informativ kemi marrë komente pozitive, gjë që e vërteton cilësinë e tyre.
- Në buletin janë publikuar 14 tregime të reja për anëtarët e RrGK-së, duke arritur në gjithsej 89 tregime të tilla.

1.2.2 Më shumë anëtare të RrGK-së janë më të afta për të ngritur fonde, për të planifikuar në mënyrë më efektive, për të udhëhequr organizata dhe për të ndërmarrë nisma avokuese më efektive

- Në tërësi, 260 persona të ndryshëm kanë marrë pjesë në punëtoritë e RrGK-së për ngritje të kapaciteteve gjatë kësaj periudhe, duke përfshirë 21% nën moshën 30 vjeç; 7% nga grupet etnike të pakicave; 3% me aftësi të kufizuara; dhe 26% nga zonat rurale.
- 27 grante janë dhënë nëpërmjet Fondit të Grave të Kosovës (FGK), duke arritur në gjithsej 78 të tilla.
- 10 projekte të FGK-së të anëtareve të RrGK-së janë përfunduar me sukses, duke arritur në gjithsej 93 të tilla.
- Cilësia e aplikacioneve për projekte të pranuar në FGK është përmirësuar, siç është vlerësuar nga Komisioni për Shqyrtim të Granteve, pas mentorimit nga RrGK-ja gjatë kësaj periudhe.
- Përmes FGK-së, janë mbështetur, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e 1,682 përfutueseve përfundimtare, duke arritur në gjithsej 15,560.
- Nga nismat avokuese të anëtareve, të mbështetura nga FGK-ja, janë realizuar 6 ndryshime të politikave, duke arritur kështu në gjithsej 15.

1.2.3 Kapacitetet e stafit të RrGK janë rritur

- Gjatë kësaj periudhe, anëtarët e stafit të RrGK-së kanë marrë pjesë në 15 punëtori për ngritje të kapaciteteve.
- Cilësia e performancës së stafit është përmirësuar, siç është vlerësuar gjatë vlerësimit vjetor të stafit.

1.3.2 RrGK ka fonde të mjaftueshme për të vazhduar operacionet kryesore të tij.

Pikat që mbeten për t'u zbatuar në lidhje me këtë objektiv

- Të vazhdojë organizimi i takimeve dymujore dhe vjetore, duke synuar që të përfshihen posaçërisht pjesëmarrësit nga grupet etnike të pakicave, nga personat me aftësi të kufizuara dhe nga zonat rurale.
- Të kontaktohen në mënyrë aktive dhe të inkurajohen sa më shumë persona që të bëhen kontribues individual të RrGK-së.
- Të vazhdohet me përfshirjen e më shumë personave të ndryshëm në punëtoritë e planifikuara të RrGK-së për ngritje të kapaciteteve, veçanërisht të kontaktohen gratë nga grupet etnike të pakicave.
- Të vazhdohet me mbështetjen e përfituesve të granteve të FGK-së në zbatimin e suksesshëm të nismave, si dhe në zbatimin e mëtejshëm të kodit të sjelljes së RrGK-së.
- Të publikohen më shumë tregime rreth RrGK-së në buletin si dhe broshura me tregime suksesi për RrGK-në.
- Të zgjerohet numri i lexuesve të buletinit dhe Instagramit të RrGK-së, dhe i faqes së FemAct në Facebook.
- Të vazhdohet sigurimi i mbulimit nga mediet i çështjeve të rëndësishme për gra dhe vajza.
- 1.3.1 Përmirësimi i vetëdijesimit institucional dhe publik për rëndësinë e zbritjeve tatimore për të mbështetur punën e rëndësishme të grupeve të të drejtave të grave

Gratë marrin pjesë në mënyrë aktive në politikë dhe vendim-marrje në nivel komunal dhe kombëtar.

- Numri i grave të zgjedhura në parlament (pa kuotë) është rritur nga 13 në 21 (nga 38 gra). RrGK-ja ka synuar të kontribuojë në këtë përmes një fushate online gjatë kësaj periudhe: "Voto për Gratë".
- 67 politika publike janë ndryshuar në atë mënyrë që të pasqyrojnë prioritetet e grave gjatë kësaj periudhe, duke arritur në gjithsej 136.
- 25 komuna dhe ministri janë duke zbatuar (disa aspekte të) buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, pas avokimit të RrGK-së.
- 188 më shumë gra të llojllojshme kanë marrë pjesë në politikë dhe në vendim-marrje në nivel komunale dhe/ose kombëtar nëpërmjet FGK-së dhe Lobit Kosovar për Barazi Gjinore (LBGjK), që përbëjnë së paku 2,086, duke përfshirë 22% nën moshën 30 vjeç, 12% nga grupet etnike të pakicave, 3% me aftësi të kufizuara, dhe 35% nga zonat rurale.

2.1 Rritet dhe përmirësohet pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendim-marrje në nivel komunal dhe qendror sipas Ligjit për Barazi Gjinore

- 47 gra të ndryshme më shumë kanë marrë pjesë në proceset politike dhe vendim-marrëse përmes nismave të anëtareve të mbështetura nga FGK-ja, duke arritur gjithsej në së paku 884.
- 44 takime më shumë janë mbajtur midis OSHC-ve dhe zyrtarëve, që arrijnë në gjithsej 556.
- Cilësia e pjesëmarrjes së grave është përmirësuar, kjo e dëshmuar nga çështjet e diskutuara ndërmjet grave dhe zyrtarëve.

2.1.1 Grupet Avokuese për Barazi Gjinore (GABG) të themeluara dhe funksionale në 27 komuna dhe në nivel kombëtar

- 28 komunat kanë grupe funksionale LBGjK si dhe grupi LBGjK në nivel mbarëkombëtar ekziston.
- Fuqia e anëtareve të LBGjK -së është përmirësuar pas takimit rrjetëzues të LBGjK -së, të mbajtur gjatë kësaj periudhe.
- Të paktën 534 gra janë përfshirë në LBGjK
- Lidhur me arritjet e LBGjK do të raportohet më shumë në dhjetor, pas takimit të planifikuar të vjeshtës.

2.1.2 Ngritja e kapaciteteve të grave në politikë për të avokuar për prioritetet e grave

- 148 seanca mentorimi janë ofruar për gratë në politikë.

2.4 Përmirësimi i institucionalizimit të Buxhetimit të Përgjegjshëm Gjinor në Kosovë

- 27 dokumente buxhetore pasqyrojnë përmirësim të perspektivës gjinore (11 kombëtare, 15 komunale), pas mbështetjes dhe avokimit të RrGK-së.
- Të paktën 44 zyrtarë kanë shfaqur vullnet politik për të provuar realizimin e BPGj-së në mënyrë të pavarur.

2.2.1 Përmirësimi i kapaciteteve të zyrtarëve të synuar për zbatimin e BPGj-së

- 33 zyrtarë janë monitoruar gjatë realizimit të BPGj-së, duke arritur në gjithsej 134.
- 45 zyrtarë kanë ndjekur punëtoritë, duke arritur në gjithsej 240.
- Siç tregohet nga monitorimi, zyrtarët kanë fituar njohuri dhe kapacitete të reja.

2.5.1 Rekomandime konkrete për përmirësimin e buxhetimit të përgjegjshëm gjinor janë prezantuar tek zyrtarët përkatës me qëllim të institucionalizimit të BPGj-së

- Janë publikuar versione të përditësuara të broshurave të BPGj-së, të cilat do të përdoren nga Instituti i Kosovës për Administratë Publike në një kurrikulë të re për shërbyesit civilë lidhur me BPGj - *Udhëzues praktik për përdoruesit: Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në nivel lokal dhe Udhëzues praktik për përdoruesit: Buxhetimi i përgjegjshëm gjinor në nivel qendror*. Dy tjerë janë hartuar (në ardhje e sipër).

Pikat që mbeten për t'u zbatuar në lidhje me këtë objektiv

- Rritja e numrit të grave të zgjedhura në kuvendet komunale, përmes avokimit dhe sensibilizimit.
- Zgjerimi i vazhdueshëm i LBGJK dhe antarësisë së tij.
- Mentorimi i vazhdueshëm për gratë në politikë, veçanërisht përmes LBGJK-së.
- Përpjekje shtesë, përmes LBGJK-së dhe FGK-së, për të përfshirë më shumë gra në politikë dhe në vendim-marrje, veçanërisht gratë me aftësi të kufizuara dhe gratë nga grupet etnike të pakicave.
- Publikimi i raporteve me rekomandime për institucione përkitazi me BPGj-në, përfshirë edhe dy raportet e planifikuara për publikim në vjeshtë të vitit 2017.
- Mentorimi i më shumë zyrtarëve në zbatimin e përgjegjësi për BPGj-në.
- Avokim shtesë për dokumentet buxhetore me qëllim që të pasqyrojnë përmirësim të perspektivës gjinore.

Gratë kanë qasje dhe janë duke i shfrytëzuar shërbimet e kujdesit shëndetësor të përbalueshëm ekonomikisht dhe cilësor.

- 58 gra më shumë kanë shfrytëzuar kujdesin shëndetësor, me mbështetje të FGK-së (përmes anëtareve "Bleri" dhe "Foleja"), duke arritur në gjithsej 3,622.
- 3 veprime të reja janë ndërmarrë nga zyrtarët me qëllim të adresimit të çështjeve që i pengojnë gratë të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor, duke arritur në gjithsej 4.

3.1 Zyrtarët publik dhe institucionet shëndetësore të jenë më përgjegjëse në adresimin e shkeljes së të drejtave të grave për kujdes shëndetësor

- Me mbështetje nga FGK-ja, 22 gra dhe burra kanë reaguar për të kërkuar përgjegjësi ndaj zyrtarëve/institucioneve, duke arritur në gjithsej 94.

3.1.2. Të ketë hulumtim për dokumentimin e shkeljes së të drejtave të grave në kujdes shëndetësor

- Është përfunduar në vitin 2016.

3.1.3. Më shumë zyrtarë publik, gra, vajza dhe burra janë në dijeni për të drejtën e grave për kujdes shëndetësor dhe shkeljet e të drejtave të tyre

- 8 takime janë mbajtur ndërmjet RrGK-së/anëtarëve të tij dhe zyrtarëve publik ku janë diskutuar të drejtave të grave, duke arritur në gjithsej 23.

3.2. Më shumë gra të kenë qasje në kujdes shëndetësor cilësor

- 58 gra kanë shfrytëzuar shërbimet e kujdesit shëndetësor si rezultat i mbështetjes së RrGK-së dhe anëtarëve të tij, nëpërmjet FGK-së, duke arritur në gjithsej 3,807.

3.2.1. Gratë dhe vajzat më të vetëdijshme për të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor dhe për rëndësinë e qasjes në kujdesin shëndetësor

- 560 gra janë më të vetëdijshme për të drejtat e tyre për kujdes shëndetësor, duke arritur në gjithsej 5,364.

3.2.2. Më shumë gra avokojnë për të drejtat e tyre për kujdes shëndetësor cilësor

- 24 gra janë përfshirë në avokim për të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor cilësor, duke arritur në gjithsej 1,563.

Pikat që mbeten për t'u zbatuar në lidhje me këtë objektiv

- 3.1.1. Kapacitetet e grupeve të drejtave të grave për të dokumentuar shkeljen e të drejtës së grave për kujdesin shëndetësor është përmirësuar.
- Inicimi i rasteve gjyqësore strategjike për t'i mbështetur gratë në realizimin e të drejtave të tyre në kujdes shëndetësor, pas shkeljes së të drejtave të tyre.

Gratë dhe vajzat jetojnë një jetë pa dhunë në baza gjinore (DhBGj)

4.1 Përmirësohet zbatimi i kornizës ligjore të dhunës në familje, duke përfshirë përgjigjet institucionale në ndihmën ndaj personave që kanë pësuar dhunë (do të matet në vjeshtë të vitit 2017).

4.1.2. Institucionet dhe akterët e tjerë janë të vetëdijshëm për shkallën në të cilën është zbatuar kuadri ligjor për dhunën në familje

- 5 takime janë mbajtur ndërmjet RrGK-së dhe anëtarëve të tij dhe zyrtarëve me qëllim të ngritjes së vetëdijesimit, duke arritur në gjithsej 51.

4.1.3. Anëtarët e RrGGK janë angazhuar për zbatimin e kornizës ligjore për dhunën në familje

- 4 nisma avokuese janë ndërmarrë përkitazi me dhunën në familje, duke arritur në gjithsej 61.

4.2. Ndërgjegjësimi dhe vëmendja lidhur me trajtimin e dhunës në baza gjinore në radhët e zyrtarëve dhe qytetarëve është përmirësuar, duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual

- Pas avokimit, janë zbatuar 2 rekomandime të hulumtimit të RrGK-së, duke arritur në gjithsej 4.
- Si rezultat i punës së RrGK-së dhe anëtarëve të tij, informata lidhur me DhBGj-në janë paraqitur 15 herë në medie, duke arritur në gjithsej 61.

4.2.1 Më shumë qytetarë të informuar në lidhje me kornizën ligjore për DhBGj-në duke përfshirë të drejtat e tyre

- Rreth 600 gra dhe burra të ndryshëm janë përfshirë në fushata për ngritje të vetëdijesimit, duke arritur në gjithsej 1,050.

4.3. Ekzistojnë politika dhe procedura të përmirësuara për trajtimin e ngacmimit seksual

- Si rezultat i punës së RrGK-së dhe anëtareve të tij, është funksionalizuar edhe një politikë , përkatësisht Universiteti i Prishtinës ka miratuar Doracakun për *Politikat që trajtojnë ngacmimin seksual në Universitetet Publike*, një doracak i hartuar nga organizata Artpolis, përpjekjet avokuese fillestare të të cilës ishin përkrahur nga FGK-ja.

4.3.1. Koordinimi i themeluar në mesin e OSHC-ve të udhëhequra nga gratë, institucioneve publike, si dhe vendeve të tjera të punës në drejtim të instalimit të mekanizmave të përmirësuara për raportimin dhe hetimin e rasteve të ngacmimit seksual

- RrGK-ja dhe anëtarët e tij kanë bashkëpunuar me 6 institucione / akterë drejt instalimit të mekanizmave të përmirësuar për raportim dhe hetim të rasteve të ngacmimit seksual, duke arritur në gjithsej 15.

4.4. Përmirësohet mbështetja institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës

- Shkalla në të cilën janë zbatuar ndryshimet që kanë të bëjnë me viktimat e dhunës seksuale në Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre, është përmirësuar pas përpjekjeve avokuese të RrGK-së dhe anëtareve të tij, megjithëse nevojitet avokim shtesë.

4.4.1. Përfshirja e RrGGK dhe e anëtareve të tij në proceset për sigurimin e mbështetjes institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës është përmirësuar

- Anëtarët e RrGK-së janë përfshirë në 3 procese gjatë kësaj periudhe, duke arritur në gjithsej 10.

Pikat që mbeten për t'u zbatuar në lidhje me këtë objektiv

- 4.1 Zbatimi i kornizës ligjore të dhunës në familje, duke përfshirë përgjigjet institucionale në ndihmë personave që kanë pësuar dhunë, është përmirësuar: aktivitete shtesë të planifikuara në periudhën 2017 - 2018, veçanërisht ato aktivitete që përfshijnë ngritjen e vetëdijesimit dhe avokimit, dhe:
 - 4.1.1. Raportet e monitorimit ekzistojnë në zbatimin e kornizës ligjore të dhunës në familje, si dhe ndërgjegjësimin rreth dhunës në familje: Në bashkëpunim të ngushtë me "Rrjetin Ballkanik për Gazetari Huluntuuese (BIRN)", RrGK ka filluar monitorimin e progresit dhe do të publikojë një raport të ri të monitorimit në dhjetor 2017.
 - 4.1.3. Anëtarët e RrGGK të angazhuara në avokimin për zbatimin e kuadrit ligjor për dhunën në familje: aktivitete shtesë të planifikuara për vjeshtën 2017 - 2018.
- 4.2. Ndërgjegjësimi i vëmendjes në trajtimin e përmirësuar të dhunës me bazë gjinore në mesin e zyrtarëve dhe qytetarëve, duke përfshirë dhunën në familje, përdhunimin dhe ngacmimin seksual: aktivitete shtesë të planifikuara në periudhën 2017 - 2018.
- 4.3. Politikat dhe procedurat e përmirësuara për trajtimin ngacmim seksual ekzistojnë: është planifikuar avokim i vazhdueshëm në bashkëpunim me anëtarët.
- 4.4. Mbështetja institucionale dhe publike për personat të cilët kanë përjetuar dhunë seksuale gjatë luftës është përmirësuar: vazhdimi i ofrimit të shërbimit të monitorimit dhe i avokimit.

Gratë dhe burrat kanë mundësi të njëjta ekonomike në shtëpi dhe në sferën publike

- RrGK dhe anëtarët e tij kanë kontribuar në rritjen e përqindjes së grave pronare në Kosovë, duke ndihmuar gratë në regjistrimin e pronës së tyre. RrGK ka kërkuar të dhënat zyrtare për të matur ndikimin e përgjithshëm, të cilat do të raportohen në dhjetor.

5.1. Më shumë gra sigurojnë punësim

- 29 gra më shumë kanë siguruar punësim pas avokimit dhe mbështetjes së RrGK dhe anëtareve të tij përmes FGK-së, duke arritur në gjithsej 304.

5.3. Më shumë gra kanë qasje në të drejtën e tyre për trashëgimi dhe pronë

- 72 gra kanë kërkuar të drejtën e tyre për trashëgimi dhe/ose pronë si rezultat i mbështetjes së RrGK-së dhe anëtareve të tij, gjatë kësaj periudhe, duke arritur në gjithsej 104.
- 200 persona më shumë kanë marrë pjesë në takimet sensibilizuese për këtë temë, të organizuara nga “Norma” gjatë kësaj periudhe, duke arritur në gjithsej 8,163.

5.5. Shkala në të cilën politikat dhe programet e BE-së përfshijnë perspektivë gjinore është përmirësuar

- 9 politika dhe programe më shumë të BE-së përfshijnë një perspektivë të përmirësuar gjinore, pas avokimit të RrGGK-së dhe anëtareve të tij, duke arritur në gjithsej 22.

5.5.1. Përmirësimi i mbikëqyrjes nga aspekti i perspektivës gjinore përkritazi me procesin e Kosovës për integrim në BE

- Është hartuar një përmbledhje monitorimi ku monitorohet perspektiva gjinore përkritazi me anëtarësimin e Kosovës në BE, që do të publikohet këtë vjeshtë, duke arritur në gjithsej 12 përmbledhje/raporte të tilla të publikuara nga RrGK-ja.
- Recensentët vullnetarë kanë e vlerësuar cilësinë e rekomandimeve si shumë të mirë, deri më tani.

Pikat që mbeten për t’u zbatuar në lidhje me këtë objektiv

- 5.1.1. Institucionet dhe akterët kryesorë janë më të vetëdijshëm për shkallën e diskriminimit gjinor në vendet e punës në Kosovë dhe për mënyrat e trajtimit të tij.
- 5.1.2. Ekzistojnë mundësi më të shumta dhe më të përballueshme për kujdesin për fëmijë.
- 5.5. Shkala në të cilën politikat dhe programet e BE-së përfshijnë perspektivë gjinore është përmirësuar përmes monitorimit dhe avokimit.

Mbështetësit

Gjatë kësaj periudhe, RrGK-ja ka arritur progres në strategjinë e vet me mbështetje nga Agjencia Austriake për Zhvillim, Bashkimi Evropian, Fondacioni “Kvinna till Kvinna”, “UN Women”, Programi “Promovimi i Punësimit në sektorin privat (PPSE)”, “*Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit* (GIZ) GmbH”, Fondacioni “Heart and Hand Foundation”, “Altrusa” dhe me mbështetjen e rëndësishme nga organizatat anëtare të RrGK-së, si dhe kontribuesit individualë. Për më shumë informata, ju lutemi shikoni raportin financiar të bashkangjitur.